



Prishtinë, 03 maj 2024
Kodi i ZRRE-së: V_2010_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, Nenit 15 dhe Nenit 26 paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Dispozitat e Nenit 8, paragrafët 1 dhe 6, të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Dispozitat e Rregullës dhe Metodologjinë për Përgatitjen e Balanceve të Energjisë Nr.03/2020 (e nxjerrë në qershor 2020); dhe
- Kërkesën e bërë me datë 11 dhjetor 2023 nga **Ndërmarrja Publike "Termokos" sh.a.**, me adresë 28 Nëntori, Ulpianë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, për miratimin e dokumentit "Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike për periudhën 2024-2033".

në seancën e mbajtur më 03 maj 2024 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET "Bilanci afatgjatë i energjisë termike për periudhën 2024-2033" i Ndërmarrjes Publike "Termokos" sh.a.**
- II. **Obligohet** i licencuari që pas pranimit të këtij Vendimi ta publikojë dokumentin "Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike 2024-2033" në faqen elektronike zyrtare të tij.

A R S Y E T I M

1. Ndërmarrja Publike "Termokos" sh.a. (në vijim NP Termokos) si bartëse e Licencës për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë termike, bazuar në dispozitat ligjore të legjislacionit në fuqi ka përgatitur dokumentin "Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike për periudhën 2024-2033". Në përputhje me procedurat ligjore dhe rregullative, drafti parë i këtij dokumenti është dorëzuar me 11 dhjetor 2023 për shqyrtim në ZRRE dhe në Ministrinë e Ekonomisë. Pas shqyrtimit dhe komentimit të këtij drafti nga këto dy institucione, me 07 shkurt 2024 është dorëzuar drafti final i përmirësuar sipas komenteve.
2. Drafti final është publikuar për konsultim publik gjatë periudhës 28.03 – 12.04.2024. Pasi që gjatë kësaj periudhe ZRRE nuk ka pranuar ndonjë koment, ky draft është konsideruar i finalizuar për tu paraqitur para Bordit të ZRRE-së për miratim.



3. Pas shqyrtimit të draft-dokumentit “Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike për periudhën 2024-2033” të dorëzuar nga NP Termokos dhe përmirësimit e plotësimit të tij sipas komenteve të ME dhe ZRRE-së, Bordi i ZRRE, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
 4. Duke pasur parasysh ndikimin e parametrave të ndryshëm të bilancit në përcaktimin e tarifave, Rregullatori mban të drejtën që gjatë shqyrtimit tariforë të përshtatë të dhënat që përmban Bilanci vjetor i energjisë termike.
 5. Bazuar në dispozitat e Nenit 42, paragrafit 2.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Rregullatori monitoron implementimin e Bilancit Vjetor të Energjisë Termike për të verifikuar realizimin e të dhënave dhe informatave të paraqitura në këtë Bilanc dhe mund të ndërmarr veprime specifike për promovimin dhe përmirësimin e sigurisë afatshkurtër dhe afatgjatë të furnizimit me energji.
- V. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodhë e fundit.


Bashkëngjitur:

“Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike 2024-2033”


Vendimi ju dërgohet:

- Ndërmarrjes Publike “Termokos” sh.a. dhe
- Arkivit të ZRRE-së


Bordi i Rregullatorit:




Ymer Fejzullahu, Kryesues




Lutfije Dervishi, Anëtare



Gani Buçaj, Anëtar



Arta Qoroll, Anëtare



Adnan Preniqi, Anëtar